



Pajtueshmëria me Rregulloret në Tregtinë Agroushqimore - Sfida dhe Progresi i Shqipërisë

Faqe 2



Ndryshon skema për naftën falas, fermerët do subvencionohen me pagesa. Fondi për naftën 12 mln euro

Faqe 6



Nga parcelat te financimi, Banka Botërore tregon formulën për të çliruar potencialin e bujqësisë

Faqe 4



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 481
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

15-ditëshi i parë i muajit mars 2024

SKEMA KOMBËTARE 2024, SUBVENCIONET NË BUJQËSI

ZBARDHET UDHËZIMI, PËRCAKTOHEN KRITERET BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2024

Aplikimi për të përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi hapet më 27 mars. Skema Kombëtare i jep prioritet mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve. Skema Kombëtare e këtij viti aplikohet pa tavane

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Denaj: Më 27 mars çelen aplikimet për financim nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi



Faqe 4

ANALIZA

Bujqësia shqiptare 'peng' e financimit të munguar! BB: Duhet garanci sovraane! Titujt e pronësisë po pengojnë zhvillimin e sektorit



Faqe 5

UNIDO

Analiza e Përputhshmërisë me Standardet: Sfidat dhe Rruga përpara për Shqipërinë në Tregjet Kryesore Botërore

Në një epokë ku globalizimi dhe tregtia ndërkombëtare janë në ekspansion të pandalshëm, roli i standardeve dhe rregulloreve teknike bëhet gjithnjë e më jetik për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve që qarkullojnë në tregjet globale...

Faqe 2

KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE



Metodat bioteknike me feromone çorientuese të çiftëzimit, për mbrojtjen e hardhisë nga tenja (Lobesia botrana)

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- **Kultivimi i ullirit - Fermerët e Vloshit me pritshmëri të larta këtë vit** Fq.5
- **Si të zgjedhim farën e misrit për një prodhim të kënaqshëm - Prof.as. Kostandin Hajkola** Fq.7
- **Këshilla për fermerët kultivues të bimës së misrit, Mars 2024 - Dr. Arzen Rexha** Fq.7
- **Inteligjenca Artificiale mban premtime joshëse për botën në zhvillim** Fq.10
- **Bimët e mbulimit të tokës për hije të thellë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari** Fq.13

SKEMA KOMBËTARE 2024, SUBVENCIONET NË BUJQËSI

ZBARDHET UDHËZIMI, PËRCAKTOHEN KRITERET BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2024

Aplikimi për të përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi hapet më 27 mars. Skema Kombëtare i jep prioritet mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve. Skema Kombëtare e këtij viti aplikohet pa tavane

EDI RAMA

V E N D I M
P Ë R

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", dhe të ligjit nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2024 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri "Transferten e buxhetit familjare" (Ilogaria ekonomike 606), të përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, të bimëve mjekësore dhe aromatike dhe të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;

b) mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave, për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

ç) mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1. Bujqësia dhe blegtoria

a) Pagesa në vlerën deri në 10 000 (dhjetëmijë) lekë/krerë lopë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/ aplikant me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB)";

b) Pagesa në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/ aplikant me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB";

c) Mbarështimi bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për fermer/ aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

ç) Pagesa në vlerën deri në 200 000 (dyqindmijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

d) Pagesë për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën deri në 30 000 (tridhjetëmijë) lekë/ha, për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

dh) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqindmijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, vitin e tretë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë dhe 200 000 (dyqindmijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) Implementimi dhe certifikimi GlobalGAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqindmijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqindmijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

2.2. Mbështetje për naftën përpunimet e mekanizuara në bujqësi

2.2.1. Mbështetje për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 1 251 600 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë e një milion e gjashtëqindmijë) lekë.

2.2.2. Subjektet përfitojnë pagesa për uljen e kostos për naftën, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.2.3. Kulturat bujqësore /grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës, për të cilën për llogaritjen vlera e përfitimit, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën llogaritet nga çmimi i publikuar në Buletinën e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik (rubrika "Të dhëna për karburantet"), me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2.2.4. Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e

mëposhtme:

i. Të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

ii. Sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.2.5. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetë deklaram.

2.2.6. Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

i. Deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

2.2.7. Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/ kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet pas kalimit të pagesës të subjektet përfituese:

i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën e përfituar, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

2.2.8. Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes për naftën për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të nënpikës 2.2.7, nënndarja "i", më sipër, ose me deklarime/ dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

3. Përmasat mbështetëse sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të nënpikës 2.1 dhe të nënpikës 2.2, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/ alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, ipërcaktuar në këtë vendim.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status "grup fermerësh" dhe "SHBB", të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

4. Përfitues përmasat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë, personat juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

5. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Financave.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".



INFORMACIONE

Analiza e Përputhshmërisë me Standardet: Sfidat dhe Rruga përpara për Shqipërinë në Tregjet Kryesore Botërore

(Vijon nga faqja 2)

Ulët i certifikatave të njohura (si nga IQNet ashtu edhe nga ISO) dhe pjesëmarrja e kufizuar në komitetet teknike të ISO. Këto janë zona ku Shqipëria ka nevojë të përqendrohet për të përmirësuar, veçanërisht në rritjen e numrit të certifikatave të njohura që janë kyçe për të rritur besimin e tregjeve ndërkombëtare në produktet dhe shërbimet shqiptare.

Dimensionet e Analizës

QI4SD analizon gatishmërinë e infrastrukturës së cilësisë nëpërmjet pesë dimensioneve kryesore: Metrologjia, Standardizimi, Vlerësimi i Konformitetit, Akreditimi dhe Politika. Në këto fusha, Shqipëria ka shënuar pikë të ndryshme, duke reflektuar një panoramë të gjerë të sfidave dhe arritjeve. Veçanërisht, performanca e lartë në Akreditim dhe Politikë tregon një infrastrukturë të fortë qeverisëse dhe rregullatore që mbështet pajtueshmërinë dhe standardizimin. Nga ana tjetër, vlerësimi i ulët në Konformitet tregon një hapësirë të qartë për përmirësim në fushën e certifikimit dhe garancisë së cilësisë.

Perspektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Rënditja e Shqipërisë në shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm (njerëz, prosperitet dhe planet) tregon një angazhim të qartë ndaj objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky angazhim është thelbësor për të siguruar që përparimi ekonomik të mos vijë në kurriz të mjedisit ose e drejtave sociale dhe të njeriut. Duke përqafuar një qasje të qëndrueshme ndaj zhvillimit, Shqipëria ka mundësinë jo vetëm të përmirësojë infrastrukturën e saj të cilësisë por edhe të kontribuojë në një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Përparësi dhe Veprime të Mëtejshme

Për të arritur përmirësime të qëndrueshme dhe për të përballuar sfidat e identifikuar nga QI4SD, Shqipëria duhet të ndërtojë një sërë veprimesh strategjike.


Këto përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes në komitetet teknike të ISO, forcimin e proceseve të certifikimit dhe rritjen e numrit të certifikatave të njohura ndërkombëtarisht. Po ashtu, është kyçe vazhdimi i investimeve në fushat ku Shqipëria ka treguar forca, siç është akreditimi dhe politikat rregullatore, për të ndërtuar mbi këto suksese dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm.

Pikat e forta	Përmasa	Renditja	Vlera	Njësia
Standardet e miratuara ISO	Standardet	9	285	Numër
Standardet e miratuara ISO	Standardet	17	16	Numër
Fushë veprimi i organeve të akreditimit të IAF	Akreditimi	38	7	Numër

Raporti identifikoi pikat e dobëta të mëposhtme, të cilat Shqipëria duhet të fokusohet në përmirësimin e tyre:

Pikat e dobëta	Përmasa	Renditja	Vlera	Njësia
Numri i certifikatave të njohura (IQNet)	Konformiteti	79	79	Numër
Numri i certifikatave të njohura (ISO)	Konformiteti	98	603	Numër
Pjesëmarrja në komitetet teknike të ISO	Standardet	130	6	Numër

Në grupin e saj të PBB-së, Shqipëria renditet në tre shtylla të zhvillimit të qëndrueshëm (njerëz, prosperitet dhe planet) si mëposhtë:



Më shumë detaje rreth Indeksit QI4SD mund të gjenden në <https://hub.unido.org/qi4sd/>.

Kultivimi i ullirit - Fermerët e Vloshit me pritshmëri të larta këtë vit

Fermeret e Vloshit janë të njohur për kultivimin e ullirit falë kushteve klimatike dhe



terrenit kodrinor të kësaj zone. Sipas statistikave të sektorit të

bujqesise ne Bashkise Roskovec, ne Njesine Administrative Kurjan, rreth 70 % e fondit të tokës bujqesore është e mbjelle me ullinj. Te nxitur edhe nga cmimi i rritur i vajit ullirit ne treg fermerët kanë shfaqur prirje për të shtuar sipërfaqet e mbjella. Kete vit vetem ne kete njesi jane mbjelle 6000 rrenje ullinj me teper.

Nebi Caushi, nje nga fermeret e Kurjanit qe zoteron rreth 5000 rrenje ullinj ka treguar se kete vit ka nje pritshmeri te larte te prodhimit te ullirit

Ne kete zone nuk ka me toka te lira per ti marre me qira pasi po shfrytezohen nga vete fermeret per te shtuar siperfaqet me ullinj.

Departamenti i Informacionit, më i madhi, më kryesor në Top Channel, i cili shënoi fillimin e televizionit me edicionin e lajmeve në 20 dhjetor 2001. Përmes informacioneve të shpejta, të sakta dhe të thelluara, reportazheve dhe rubrikave të tjera informative, Top Channel është kthyer në burimin kryesor dhe me prestigjioz të informimit të të gjithëve në Shqipëri, në hapësirën mbarëshqiptare dhe kudo tjetër në botë ku shqiptarët jetojnë. Top Channel është i pranishëm me kamerat dhe gazetarët e tij në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të vendit dhe në botë, me edicionet e tij informative.

Analiza - Bujqësia shqiptare 'peng' e financimit të munguar! BB: Duhet garanci sovrane! Titujt e pronësisë po pengojnë zhvillimin e sektorit

Zhvillimi i sektorit bujqësor në Shqipëri po pengohet nga mungesa e financimit, mungesa e titujve të bujqësisë, fragmentimi i tokave dhe infrastruktura e ulët në ujtitje. Në një analizë të Bankës Botërore thuhet se Shqipëria duhet të miratojë skema garancie sovrane për të rritur financimin e sektorit si dhe të përmirësojë infrastrukturën ujtitëse

Investimet e pakta në infrastrukturë me fokus zhvillimin rural, fragmentimi i tokave, mungesa e titujve të pronësisë dhe financimi i ulët i fermerëve janë faktorët kryesor që po pengojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Në një analizë të bërë për bujqësinë nga Banka Botërore, thuhet se sektori që kontribuon në 20% të PBB-së dhe që është

mijë ferma, por madhësia e tokës që kanë në dispozicion është mesatarisht 1 hektar dhe pjesa më e madhe e shpërndarë, po ul produktivitetin e sektorit. Sfidë për vendin mbetet edhe regjistrimi i titujve të pronësisë, pasi vetëm 10% e titujve janë të regjistruar në mënyrë digjitale.

“Aktualisht, 10% e titujve të tokës janë të regjistruara në

eziqet që lidhen me kapitalin qarkullues të pamjaftueshëm”, thuhet në analizë.

Vendit i propozohet të investojë më shumë në ujtitje në mënyrë që të forcohet qëndrueshmëria përballë kushteve atmosferike, si dhe të përmirësohen procedurat doganore me qëllim që të ulen kostot e eksportit dhe të rritet konkurrenca e mallrave shqiptare në tregjet e huaja.

Për shkak të këtyre pengesave në analizë thuhet se tregjet e BE-së ofrojnë çmime shumë më të larta se tregjet e Ballkanit Perëndimor, por eksportet shqiptare në BE mbeten kryesisht të kufizuara në mallrat e përpunuara minimalisht me nivele të ulëta të vlerës shtesë. Madje sugjerohet që të rriten dhe fuqizohen kapacitetet laboratorike në mënyrë që të garantohet siguria ushqimore në parametrat e BE.

Katër rekomandimet që Banka Botërore i bën Shqipërisë në përfundim të gjithë analizës janë: adresimi i problematikës së pronësisë e fragmentimit të tokës,



burim kryesor punësimi për rreth 40% të popullsisë, po bën progres më pak se në vendet e rajonit.

Mungesa e financimit është shkak kryesor që po ndikon negativisht në sektor, për këtë arsye propozohet që të miratohen skema garancie sovrane, për të lehtësuar fermerët drejt aksesit në financë.

Sektori i bujqësisë ka marrë vetëm 3% të totalit të kredisë që kanë dhënë Bankat, dhe madje një pjesë e madhe e popullsisë rurale nuk ka akses në institucionet zyrtare financiare.

“Kapitali qarkullues i pamjaftueshëm çon më pas në cilësi të dobët të farës, mekanizim të kufizuar dhe nivele të ulëta të përdorimit të plehrave për hektar, duke minuar më tej produktivitetin”, vijon më tej Banka Botërore.

Po ashtu fragmentimi i tokave ku Shqipëria ka 359

mënyrë dixhitale, ndërsa 80% janë të regjistruara vetëm në format letre. Dhjetë për qind nuk janë fare të regjistruar.



Mungesa e titujve të tokave dhe dokumenteve të regjistrimit e bën të vështirë për fermerët aksesin e financimit, duke përkeqësuar investimet e pamjaftueshme dhe duke rritur rr-

përmirësimi i infrastrukturës ujtitëse dhe transportit, rritja e standardeve ushqimore dhe forcimi i lidhjeve sektoriale për konkurrencë më të lartë të eksporteve.

Bimët dekorative - Ringjallet biznesi në Obot dy vjet pas përmbytjeve

14 muaj me parë, i gjithë mudi i Nikolin Çukajt me 50.000 rrenjë bime dekorative ishin nën ujë pasi përmbytjet kishin përfshirë të gjithë fshatin e Obotit. Sot, falë kushteve atmosferike të pershtatshme, në këtë fshat fatmiresisht nuk ka përmbytje, ndonëse në vitet e fundit, në këtë periudhë, fshatarët janë perballur sistematikisht me vërshimin e ujrave. Fermerin, Nikolin Çukaj, kete herë e gjejme ne krye të detyres duke i sherbyer, luleve dekorative.



Subtitles/closed captions una

SUBVENCIONE

Ndryshon skema për naftën falas, fermerët do subvencionohen me pagesa. Fondi për naftën 12 mln euro

Për të katërtin vit, fermerët e sektorit të bujqësisë do të mbështeten me naftë falas. Skema që nisi zbatimin nga viti 2021, për këtë parashikon mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi në vlerën e rreth 1,2 miliardë lekëve.

Por ndryshe nga vitet e kaluara,

luledielli, sojë, sorgum normativa e konsumit është 190 litra/ha. Sasia e naftës që përfitohet është 97 litra për ha. Këtë vit,

8,789 lekë/ha.

Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: i. të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës; ii. sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet është, si: deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi; për sipërfaqen mbi 10 ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

Vendimi përcakton se aplikimet do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren.

Procesi i kontrollit në terren kryhet pas kalimit të pagesës te subjektet përfituese: i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të

faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën e përfituar, e cila të jetë jo më e madhe se 20%; ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë

kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes për naftën për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20% ose me dekla-

rime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 vjet nga drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.



subjektet nuk do të tërheqin sasinë e naftës përfituese, por do të përfitojnë pagesa për uljen e kostos për naftën, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në vendimin e Ministrisë së Bujqësisë të botuar në Fletoren Zyrtare.

Referuar tabelës për normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës, për të cilën përlllogaritet vlera e përfitimit sipas kulturave të mbjellave për grupin e parë të kulturave si: misër, fasule,

fermeri subvencionin e naftës e përfiton në vlerë. Për këtë grup kulturash vlera që përfitohet është 18,789 lekë/ha.

Për grupin e dytë e të mbjellave, si: grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk) është 12,784 lekë/ha.

Për grupin e tretë të mbjellave me foragjereshumëvjeçare, bimë aromatike-mjekësore do të përfitohet 8,910 lekë/ha.

Ndërsa për drurët frutorë dhe të perimeve të fushës dhe serrës, pagesat për naftën variojnë nga 3,946 lekë/ha deri

Skemat e subvencioneve të akorduara nga buxheti i shtetit ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqet e kultivuara. Pjesë e skemave është edhe kultivimi i perimeve në sera dhe në fushë të hapur, luleshtrydhet në tunele plastike dhe bimët aromatiko-mjekësore.

Skema e subvencioneve për blegtorinë për vitin 2024

Subvencionet në bujqësi zakonisht zbatohen për të mbështetur fermerët, për të stabilizuar tregjet bujqësore dhe për të garantuar sigurinë ushqimore. Kjo formë mbështetje ose siç quhet “Pagesat Direkte” janë një formë e mbështetjes që shpesh janë të shkëputura nga nivelet aktuale të prodhimit dhe synojnë të ndihmojnë fermerët të stabilizojnë të ardhurat e tyre përballë luhatjeve të tregut. Gjatë muajit Mars 2024, blegtorët Shqiptarë do të drejtohen portalit e-Albania për të kryer procesin e aplikimit.

Çfarë përfshijnë subvencionet për blegtorinë gjatë 2024?

1) Pagesa në vlerën deri në 10,000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë)

hjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor-SHBB”.

2) Pagesa në vlerën deri në 1,200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi. Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

3) Mbarëshitim i bletarisë në vlerën deri në 1,000 (një mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje. Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

4) Subvencionimi i naftës për aktivitetet blegtorale. Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë, bëhet me vetëdeklarim.

i). Deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra, referuar tabelës më poshtë.

ii). Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit

Skemat kombëtare 2024

zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqet e kultivuara. Pjesë e skemave është edhe mbështetja

cionet për perimoret dhe bimët aromatiko-mjekësore për vitin 2024?

Nr./Kodi	Kultura bujqësore/ grup-kulturash	Normat. punimeve të mekanizuara	Sasia e naftës që përfitohet*	Vlera që përfitohet	Specifikime
		Litra/ha	Litra/ha	Lekë/ha	
A	Bimë arash				
A.1	Grupi 1	190	97	18,789	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	66	12,784	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)

Skema e subvencioneve për perimoret dhe bimët aromatike mjeksore për vitin 2024

Skemat e subvencioneve të akorduara nga buxheti i shtetit ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore duke ulur

e fermerëve me pagesën e naftës për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore. Gjatë muajit Mars 2024, fermerët që kultivojnë perime në fushë të hapur, apo sera, si dhe ato që kultivojnë bimë aromatike-mjekësore do të drejtohen portalit e-Albania për aplikim.

Çfarë përfshijnë subven-





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

KËNDI I MBROJTJES INTELEJENTE TË BIMËVE

Metodat bioteknike me feromone çorientuese të çiftëzimit, për mbrojtjen e hardhisë nga tenja (*Lobesia botrana*)



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Një përpjekje e përhershme e shkencës dhe e prodhimit në vreshtari, ka qenë dhe mbetet kufizimi i mbrojtjes kimike me insekticide dhe zevëndësimi i tyre me mjete të padëmshme për shëndetin dhe mjedisin.

Një kontribut të madh kanë dhënë për këtë objekt, prodhimi nga industria e feromoneve si mjete mbrojtjeje ndaj insekteve, duke kufizuar në maksimum përdorimin e insekticideve.

Një sukses i tillë zbatohet në vreshtarinë Europiane në mbrojtjen e hardhisë nga tenja e rrushit, insekti numër një në vreshta, e cila dëmton direkt bistakët e rrushit.

Feromonet janë substance organike, të cilat prodhohen nga gjëndrat seksuale të insekteve për të lehtësuar çiftëzimin e tyre. Sunstancat tërheqëse i lëshojnë fluturat femra për të realizuar kontaktin e tyre me fluturat meshkuj, të cilët janë në distanca nga njeri tjetri në vreshtë.

Feromonet industrialë, të cilët janë një kopjim i formulës së feromit të femrës reale të tenjës së rrushit, kur përhapen në vreshtë gjatë avullimit, krijojnë një re të madhe të këtij hormoni të femrës, saqë, fluturat meshkuj çorientohen dhe nuk e gjen dot fluturën femër. Ky mekanizëm nuk realizon çiftëzimin dhe kështu fluturat femra mbesin jo pjellore për vezë, e për pasojë nuk kemi larva që të na dëmtojnë bistakët e rrushit.

Substanca organike e feromit të femrës formulohet në disa tela plastike me ngjyrë të kuqe tulle në formën e një fije makaroneje me gjatësi 20-25 cm.


Këto fije të feromit, të cilat quhen dispensëra, varen në vreshtë.

Kur varen fijet e feromit në vreshtë?

- Varen me fillimin e lulëzimit të hardhisë dhe gjatë tij..


Si është skema e varjes në vreshtë? Varen përgjatë rreshtit të hardhisë çdo 6-7 metra dhe në gjerësi 4 metra. Kjo distancë katër metra realizohet kur fijet e feromit (dispensërat) varen në një rresht po dhe në një rresht jo. (shiko shikicën)

Një dispensër mbron 25-30 metra katrorë vreshtë. Për një ha vreshtë përdoren 500 fije dispensëri.



Pamja e fijes së dispensërit të feromit çorientues të tenjës së hardhisë

Skema e varjes së feromoneve në fushë



Zona e Izolimit:

Ka një kërkesë teknike. Distanca e një vreshti të trajtuar me feromone çorientuese nga ai i patrajtuar, duhet të jetë mbi 100 metra larg, sepse vijnë fluturat pjellore të vreshtit të patrajtuar dhe lëshojnë vezë në vreshtin e trajtuar me feromone çorientuese.


Rezultatet e metodës:

Në provat trevjeçare tregohen në grafikun e mëposhtëm.

Në variantin e trajtuar me feromone çorientuese infeksioni në vjelje ka qenë 3% e bistakëve me larva të tenjës.

mbrojtjeje, vreshtat në Gjermani dhe Zvicër trajtohen në mbi 60% të sipërfaqes..

Nga nga viti 2001, kur janë përdorur për herë të parë, në Shesh të Tiranës e deri më sot, sipërfaqja ka mbetur nga 10 deri në 20 ha. Kjo nuk është fare një shembull pozitiv, kur sot




Paketa me 500 fije dispensërash




Tufa me 100 fije dispensëras të feromit



Varja e dispensërat në vreshtë Ishëm, Durrës (majtas) dhe në Mrizin e Zanave, Zadrimë, Lezhë



Flutura e tenjës së hardhisë (*Lobesia botrana*) dhe dëmi i larvave në kokrrat e bistakut të hardhisë.



Në variantin e trajtuar me insekticide konvencionale infeksioni ka qenë 10% të bistakëve.

Në variantin, kontroll, pa trajtime infeksioni ka qenë 20% të bistakëve.

Feromoni çorientues e mbron hardhinë për të gjithë sezonin, deri në vjelje

Me këtë metodë bioteknike

flasim për një higjenë të lartë të ushqimit dhe mjedisit. Feromonet çorientuese duhet të jenë pjesë e subvencioneve në vreshtari, për të nxitur prodhimin biologjik dhe atë të integruar.

Feromonet janë të regjistruara për përdorim edhe në bujqësinë biologjike.

Jemi në kohë për importimin e këtyre produkteve edhe në këtë sezon 2024.

Kredi Agrobiznes ☰

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

